

MONITORIMI

I PLANIT AKSIONAR PËR STRATEGJINË LOKALE TË KOMUNËS SË STRUGËS PËR TË RINJTË

2015 - 2017



Përgatitja e këtij raporti, financiarisht është mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedoni, si pjesë e aktiviteteve të Konceptit Komunë sipas masës së qytetarëve.



MONITORIMI

I PLANIT AKSIONAR PËR
STRATEGJINË LOKALE TË
KOMUNËS SË STRUGËS

PËR TË RINJTË

2015 - 2017

Strugë, dhjetor 2016

Publikues: Shoqata „Kreativë dhe Aktivë“

Për publikuesin: Halit Lita, kryetar

Autorë: Ardita Istrefi Iljazi, Kristina Vasileska

Redaktor dhe recenzues: D-r Borçe Trenovski

Redaktorë nga Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedoni:

Dançe Danillovska-Bajdevska

Natasha Angjeleska

Lektorimi: Shefajet Murtezai-Dervishi

Përkthimi në gjuhën shqipe: Shenasi Jaji

Dizajni dhe përgatitja: Brigada dizajn



Përgatitja e këtij raporti, financiarisht është mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedoni, si pjesë e aktiviteteve të Konceptit Komunë sipas masës së qytetarëve.

PËRMBAJTJA

REZYME EKZEKUTIVE	4
1. HYRJE	6
2. KARAKTERISTIKAT SOCIO-EKONOMIKE DHE DEMOGRAFIKE TË KOMUNËS	8
3. PRIORITETET DHE PARIMET STRATEGJIKE PËR TË RINJË TË KOMUNËS SË STRUGËS	10
4. METODOLOGJIA E PROCESIT TË MONITORIMIT	14
5. ANALIZA E TË DHËNAVE DHE KONKLuzionET KRYESORE	16
6. KONKLuzionE DHE REKOMANDIME	26
7. BURIMET	29
8. ANEKS	32

REZYME EKZEKUTIVE

Raporti i monitorimit ka për qëllim për të përcaktuar shkallën e implementimit të Planit aksionar për strategjinë lokale për të rinjë 2015-2017. Më konkretisht, objektivi kryesor gjatë zbatimit të monitorimit dhe analizimit të të dhënave është dhënia e vlerësimit të qartë të asaj se sa institucionet (komuna, OJQ-të, institucionet arsimore, etj) i realizojnë aktivitetet e tyre dhe sa përdoruesit e fundit i ndjenjë rezultatet e tyre.

- Nga gjithsej 41 shfrytëzues dhe trupa të monitoruara përgjegjëse për implementimin e strategjisë dhe planit aksionar, përgjigje për takim ose plotësim të pyetësorit me email kemi pasur nga 28 organizata/institucione, respektivisht 68% të organizatave/institucioneve të planifikuara.
- Shkalla e realizimit të Planit aksionar është 39% përqind. Kjo është rezultat i natyrës kuantitative por edhe treguesit kualitativë tregojnë se realizimi i aktiviteteve është i ulët.
- Nga gjithsej 51 aktivitetet të planit aksionar të parashikuara për implementim për periudhë prej tre vitesh 2015-2017: 25% të aktiviteteve janë të planifikuara në vitin 2015, 33% të aktiviteteve janë të parashikuara të implementohen në vitin 2016, ndërsa në vitin 2017 ka aktivitete të cilët implementohen në vazhdimësi gjatë tre viteve të planit aksionar, respektivisht 39% të aktiviteteve të përgjithshme për realizim.
- Implementimi i aktiviteteve - nga gjithsej 51 aktivitetet të planifikuara sipas kornizës kohore të planit, 39% janë aktivitete të implementuara, kurse 61% janë aktivitete të parealizuara.
- Në vitin 2015, nga gjithsej 13 aktivitete të planifikuara për implementim, vetëm 69% janë aktivitete të realizuara dhe 31% mbeten aktivitete të parealizuara në kornizën e parashikuar kohore.
- Në vitin 2016, nga gjithsej 17 aktivitete të planifikuara për implementim, 72% të aktiviteteve nuk janë implementuar dhe vetëm 28% nga to janë realizuar.

- Aktivitetet që ishin planifikuar të zbatohen gjatë këtyre tre viteve 2015-2017 përfundimisht me vitin 2016, 55% të aktiviteteve janë realizuar ndërsa 45% nuk janë implementuar.

Në Strategjinë dhe Planin aksionar është parashikuar kornizë fleksibile dhe raport tolerant në dinamikën e zbatimit të aktiviteteve, që sipas mendimit tonë është bërë me qëllim që të merren parasysh edhe mangësitë në funksionimin e sistemeve komunale. Komuna, më saktësisht administrata komunale nuk ka kapacitet të mjaftueshëm për ti zbatuar të gjithë aktivitetet e parashikuara në planin

aksionar të dala nga strategjia. Komuna nuk ka pasqyrë të informacioneve për aktivitetet e realizuara, iniciativat e ndërmarra, aktorët relevantë dhe kyq për zbatim, rezultatet dhe indikatorët. Të gjitha të dhënat e grumbulluara në administratën komunale për këtë raport janë kryer përmes mbledhjeve të posaçme me persona në sektorët dhe njësitë, me çka tregohet se nuk ka sistem të unifikuar për monitorimin e implementimit të planit aksionar dhe strategjisë për të rinjë, edhe pse ajo është përmendur në vetë strategjinë (duhet të emërohet person përgjegjës për monitorimin e implementimit të Strategjisë për të rinjë në Komunën e Strugës 2015-2020 nga ana e Kryetarit të Komunës).

1. HYRJE

Strategjia lokale dhe plani aksionar për të rinjë në Komunën e Strugës, si dy dokumente kryesore të qeverisjes së mirë, janë instrumente plotësuese me të cilat udhëhiqet komuna e Strugës në implementimin e ligjeve dhe rregullativës shtetërore, me qëllim që publiku të ketë informacione dhe qasje se si punon komuna. Në mënyrë shtesë, këto dokumente strategjike gjithashtu janë të domosdoshme që të tregohet se si është vullneti dhe qëllimi i komunës për të informuar publikun dhe bashkëndarë këto informacione të cilët janë të rëndësishme së jashtëzakonshme.

Duke u nisur nga kjo nevojë, Kreativë dhe Aktivë realizuan monitorimin e informacione themelore përmes katër perspektivave dhe qëllimeve të tyre prioritare strategjike. Monitorimi kishte për qëllim të masë zbatimin e planit aksionar për strategjinë lokale për të rinjë 2015-2017. Më konkretisht, qëllimi ynë gjatë zbatimit të monitorimit dhe analizës së të dhënave është që të japim vlerësim të qartë për atë se sa institucionet (komuna, OJQ-të, institucionet arsimore, etj) i realizojnë aktivitetet e tyre dhe sa përdoruesit e fundit i ndjenjë rezultatet e tyre.

Shoqata për të rinjë dhe kulturë „Kreativë dhe Aktivë “ – Strugë (KA) duke filluar nga korriku 2016 deri dhjetor 2016 e

ka ndjekur zbatimin e strategjisë lokale dhe planit aksionar për të rinjë të Komunës së Strugës. Monitorimi zhvillohej në kuadër të projektit „Monitorimi i planeve aksionare dhe strategjive lokale të Komunës së Strugës “ të mbështetura financiarisht nga Fondacioni Shoqëria e Hapur -Maqedoni. Realizimi i planit aksionar dhe monitorimi i strategjisë dhe planit aksionar për të rinjë në Komunën e Strugës nga ana e të gjithë aktorëve është analizuar nga tre pika referente:

- Implementimi mbi bazën e prioriteteve dhe qëllimeve strategjike,
- Informimi, përfshirja dhe implementimi i organeve të tjera sa i përket strategjisë lokale për të rinjë dhe planit aksionar,
- Implementimi i planit aksionar në periudhën 2015-2017.

Strukturat kompetente për mbështetje institucionale dhe jashtëinstitucionale të zhvillimit të politikave për të rinjë duhet që ti përshtasin programet me Planin aksionar dhe

të njejta ti bëjnë komplementare me masat dhe aktivitetet. Në kushte kur Komuna e Strugës në kuptim të vërtetë e pranon rolin e bartësit dhe përgjegjësitor kryesor për zbatimin e Planit aksionar dhe të jetë iniciatori kryesor që të gjithë palët e përfshira të përforcojnë ndjenjën e pronësisë mbi dokumentin, vetëm atëherë Plani aksionar në sistemin lokal për të rinjë do ta merr peshën e tij të vërtetë.

2. KARAKTERISTIKAT SOCIO-EKONOMIKE DHE DEMOGRAFIKE TË KOMUNËS

Të dhënat demografike tregojnë rritje të numrit të popullsisë nga 63 376 banorë, sipas regjistrimit të fundit të vitit 2002, në 65 395 sipas vlerësimit të fundit vjetor të popullsisë më 31.12.2014. Sipas strukturës së moshës, dominojnë personat në moshë prej 34 deri 59 vjet (34%), pastaj personat në moshë prej 20 deri 34 vjet (28%). Sa i përket përkatësisë nacionale, Komuna e Strugës është bashkësi e përzier etnike me shumicë të popullsisë shqiptare prej 57%, maqedone 32%, turke 6%, vllehe 1% dhe më pak se një përqind janë egjiptianë, romë, boshnjakë, serbë dhe të tjerë¹.

Sa i përket banimit, siç po rritet numri i popullsisë në komunë, ashtu po rritet edhe numri i banesave të përgjithshme në Strugë. Sipas të dhënave të regjistrimit të viti 2002, numri i banesave (shtëpive) ishte 18 300, ndërsa në periudhën prej vitit 2005 deri në vitin 2014 janë ndërtuar edhe 2 365 banesa plotësuese. Në to kanë jetuar 63 376 banorë, të ndarë në 14 483 amvisëri individuale, me numër mesatar të anëtarëve të amvisërive = 4.4. Në komunë nuk ka banesa sociale për grupet e rrezikuara sociale.

Të dhënat zyrtare për numrin e përgjithshëm të subjekteve aktive afariste tregojnë përfaqësim më të madh të ndërmarrjeve të vogla, por edhe trend të uljes së numrit të ndërmarrjeve të vogla në vitet e fundit. Ulja në veçanti është e shprehur te ndërmarrjet e vogla ku për periudhën 2009 – 2012 ka ulje për 50% të plota. Sa i përket sektorëve të veprimtarisë, dominojnë tregtia me shumicë dhe pakicë, objektet e qëndrimit dhe shërbimet e servisimit për ushqim dhe ndërtimtari.

Numri i përgjithshëm i personave të regjistruar të papunë në tetor të vitit 2015 ishte 8 504. Nga to, si kërkues aktivë të punës janë regjistruar 38%, ndërsa 62% janë të papunë të tjerë. Numri më i madh i personave të regjistruar të papunë janë me arsim fillor dhe të mesëm. Sa i përket përkatësisë nacionale, numri më i madh i kërkuesve aktivë për punë janë maqedonas edhe pse në komunë shumicë janë popullsia shqiptare. Meshkujt të gjitha bashkësitë etnike janë më shumë prezent si kërkues aktiv të regjistruar për punë. Gjendja me përfshirjen në arsimin fillor në Komunën e Strugës, viteve të fundit tregon se ka ulje të numrit të nx-

¹ Informacione më të gjëra dhe më të detajuara për karakteristikat socio-ekonomike dhe demografike të Komunës së Strugës shiko: Harta sociale e Komunës së Strugës 2016 në dispozicion në: <http://www.soros.org.mk/mk/Home/Publication?newsID=6152&catID=100&pageIndex=1>, si dhe <http://www.struga.gov.mk/index.php/mk/>

ënësve sipas viteve shkollore. Por, nuk ka dallime të konsiderueshme ndërmjet vajzave dhe djemve, ndërsa raporti mësues – nxënës në komunën e Strugës është 8:1, me përfaqësim më të madh të femrave mësuese.

Numri i pensionistëve në Komunën e Strugës, përfundimisht me tetorin e vitit 2015 është 10 792. Në komunë nuk ka kapacitete akomodimi për kujdesin e personave të moshuar (pleq). Numri i familjeve, shfrytëzues të ndihmës sociale në para në fund të vitit 2014 ishte 384, plus kishte 78 shfrytëzues të kompenzimit në para me kusht dhe 172 shfrytëzues të kompenzimit për varfëri energjetike.

3. PRIORITETET DHE PARIMET STRATEGJIKE PËR TË RINJË TË KOMUNËS SË STRUGËS

Komunat janë burimet kryesore për financimin e punës rinore. Shumë problem që ndodhin në nivel local ndërsa janë të lidhura me të rinjtë, nga njëra anë janë pasojë e mungesës ose pamundësisë së Komunave për ti mbështetur politikat rinore, ndërsa nga ana tjetër janë rezultat i mungesës dhe mos stimulimit të aktivizmit rinor. Komuna e Strugës në tërësi i ka identifikuar rëndësinë dhe rolin e të rinjve në zhvillimin e proceseve demokratike në Komunë dhe, në përgjithësi, në zhvillimin dhe përmirësimin e jetës në komunitet. Duke u nisur nga këto fakte, Komuna E Strugës vendosi ti mobilizojë të gjithë palët e interesuara/prekura në lidhje me çështjen e rinisë në Komunë, të nxisë aktivizmin rinor në Komunë, të avancojë bashkëpunimin me rininë dhe të kontribuojë në zhvillimin e tyre të vazhdueshëm. Rezultat i këtij përkushtimi është kjo „Strategji për të rinjë e Komunës së Strugës 2015-2020“², e cila ka të bëjë me bashkëpunimin e Komunës me të gjitha palët e interesuara/prekura nga politikat locale për rininë dhe ka për qëllim të sigurojë proces gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrje

të sektorit civil në proceset e definimit të aktiviteteve dhe iniciativave zhvillimore të Komunës së Strugës në fushën e të rinjve, si dhe të krijojë parakushte për krijimin e partneriteteve efikase. Dokumenti është përgatitur në mënyrë konsultative dhe participative, me përfshirje të konsiderueshme të organizatave rinore dhe administrates komunale gjatë periudhës mars-nëntor të vitit 2014.

Monitorimi i vazhdueshëm dhe realizimi i masave dhe iniciativave të përmbajtura në dokumentin nga ana e Kryetarit të komunës, Administratës komunale dhe Këshillit të Komunës si dhe mbështetja përkatëse financiare, do të sigurojnë plotësimin e vizionit dhe besimin në përkushtim, transparencën dhe efikasitetin e Komunës së Strugës për zgjidhjen e problemeve dhe nevojave të rinisë. Strategjia është përgatitur mbi bazën e Raportit për gjendjen momentale në Komunën e Strugës dhe Analizës strategjike, të cilët janë dhënë si dokumente shoqëruese të Strategjisë, ndërsa e njehta është shoqëruar me Planin aksionar (subjekt i këtij monitorimi - Raporti), në të cilin janë përpunuar aktivitete

² Më gjërësisht për strukturën/aktivitetet e strategjisë, vizionin, parimet dhe pasqyrën e detajuar të prioriteteve strategjike shiko Strategjia për të rinjë e Komunës së Strugës 2015-2020, në dispozicion në: <http://foom.mk/mk/Home/Publication?newsID=49700&catID=100&pageIndex=2>

konkrete dhe I cili do të kontribuojë në përmbushjen e prioriteteve dhe masave strategjike në drejtim të plotësimit të vizionit të Komunës.

Në kuadër të Strategjisë është definuar Vizioni i Komunës së Strugës për të rinjtë i cili thotë: **TË RINJTË NË KOMUNËN E STRUGËS JANË BARTËS DHE FAKTOR INTEGRAL NË NDËRTIMIN E SHOQËRISË CIVILE MULTIKULTURORE, JETËS EKONOMIKE DHE KULTURO-SOCIALE DHE MJE-DISIT JETËSOR.** Ky vizion i Komunës së Strugës do të sigurohet me respektimin e përpiktë të parimeve dhe vlerave të përcaktuara në partneritet me të rinjtë, përmes: rritjes së mëtejshme të shumave të mjeteve financiare nga Buxheti i komunës dedikuar për programet e rinisë në Komunë; zhvillimit të kapacitetit administrativ komunal, si dhe kapaciteteve të organizatave rinore; futjes së modeleve inovative për zgjidhjen e problemeve dhe nevojave të rinisë në Komunë dhe zgjerimit të politikave dhe shërbimeve komunale sipas pritjeve dhe dobisë së të rinjve dhe qytetarëve nga puna e Komunës, në drejtim të ndërtimit të shoqërisë civile dhe multikulturore, kushteve për jetë ekonomike dhe kulturo-sociale, si dhe mjedisit të shëndoshë jetësor.

Procesi i realizimit të prioriteteve dhe masave strategjike për përmbushjen e vizionit të Komunës së Strugës për bashkëpunim me të rinjtë në periudhën 2015-2020, do të nisët sipas këtyre **parimeve dhe vlerave:**

- **Barazia** – Komuna e Strugës do të mundësojë që të gjithë të rinjtë të kenë të drejtë për shanse të barabarta, të drejtë të informimit, të drejtë të uhvillimit personal, mësim të përjetshëm dhe të drejtë të punësimit në përputhje me karakteristikat e ndryshme personale, zgjedhjet dhe aftësitë.
- **Multikulturalizmi** – Komuna e Strugës do të mundësojë respektimin e dallimeve në të gjitha fushat e jetës njerëzore, tolerancën, si dhe afirmimin e qasjeve creative dhe artistike të drejtuara kah ruajtja dhe zhvillimi i dialogut multikulturor ndërmjet të rinjve.
- **Transparenca** – do të promovohet nivle më i lartë i publikueshmërisë së informacioneve që disponon, shërbimeve që ofron, procedurat sipas së cilave ekzekutohen dhe kriteret sipas së cilave sigurohen. Komuna do të sigurojë qasje në drejtim të njohjes së problemeve dhe nevojave të të rinjve nga ana e komunitetit të tërë lokal.

- **Llogaridhënia** – llogaridhënie për punën e pushtetit lokal (Kryetari I komunës, Këshilli dhe administrata), çka është dhe çka nuk është realizuar në kuadër të Programeve të parashikuara komunale, me raporte të detajuara financiare të programeve, projekteve, masave dhe aktiviteteve të realizuara.
- **Pjesëmarrja aktive e të rinjve** – Komuna e Strugës do të sigurojë të drejta, mbështetje, mjete, hapësirë dhe mundësi që të munden rinia të marrin pjesë në procesin e miratimit të vendimeve si dhe në aktivitetet që kontribuojnë për ndërtimin e shoqërisë më të mirë.
- **Disponibiliteti** – Komuna do të mundësojë dhe do të sigurojë qasje për të rinjtë deri te të gjitha resurset. Komuna do të sigurojë kushte për ruajtjen e shëndetit të rinjve dhe shfrytëzimin cilësor të kohës së lirë. Komuna do ta afirmojë dhe stimulojë futjen graduale dhe zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet.
- **Inovacioni** – vazhdimisht do të kërkohen procedura spontane dhe sistemore për futjen e mënyrave të reja për zbatimin më efikas, efektiv dhe cilësor të detyrave të punës.
- **Përgjegjësia** – Komuna do ta stimulojë dhe do ta zhvillojë përgjegjësinë për ata që punojnë me të rinjtë si dhe përgjegjësinë e të rinjve në përputhje me mundësitë e tyre.
- **Solidariteti** – Komuna e Strugës e mbështet solidaritetin ndër gjeneratave dhe rolin e të rinjve në ndërtimin e shoqërisë demokratike. Në Komunë nxiten të gjitha format e solidaritetit të gjeneratave, kulturës pa dhunë dhe tolerancës ndërmjet të rinjve.
- **Bashkëpunimi** – Mbështetet dhe sigurohet liria e bashkimit dhe bashkëpunimit me moshatarët dhe nxitet bashkëpunimi ndërmjet gjeneratave në nivel local, nacional dhe ndërkombëtar.

Qëllimet e Planit aksionar për strategjinë lokale për të rinj në Komunën e Strugës për periudhën 2015 – 2017

Qëllimi kryesor i Planit aksionar për zbatimin e Strategjisë lokale për të rinjë në Komunën e Strugës për periudhën 2015 – 2017³ është që të zhvillojë aktivitete kyçe që duhen të zbatohen që të sigurohet implementim i suksesshëm i Strategjisë. Së bashku, Strategjia dhe Plani aksionar do të jenë veglat kryesore që do ta udhëheqin Komunën e Strugës nëpër proceset për të përmbushur vizionin për zhvillimin, vendin dhe rolin e të rinjve në Komunë në periudhën 2015 – 2020.

Plani aksionar i definon aktivitetet për bashkëpunimin e Komunës me të rinjtë që duhet të ndërmerren në periudhën 2015 – 2017. Zbatimi i Strategjisë në këtë periudhë kohore bazohet mbi kriteret e nevojës prioritare dhe qasjes reale të mjetet financiare për realizimin e aktiviteteve në përputhje me buxhetin e parashikuar të Komunës dhe burimet e tjera të financimit. Ndër të tjera, pjesë e aktiviteteve të parashikuara janë të filluara dhe mbaruara në kornizën e parashikuar kohore, por realizimi i tyre i plotë do të kryhet në periudhën e parashikuar për zbatimin e plotë të Strategjisë (2020). Për atë qëllim, kah fundi i vitit 2017 duhet të përpiqet plan aksionar për periudhën 2018 – 2020.

Duke pasur parasysh faktin se në Komunën e Strugës nuk ekziston njësi e veçantë as edhe sektor për bashkëpunim me të rinjtë, zbatimi i Planit aksionar në nivel vjetor zhvillohet përmes programeve vjetore të përpiluara për fusha të ndryshme të kompetencës së Komunës së Strugës ose, me përpilimin e programit të veçantë ndërsektorial për bashkëpunim me të rinjtë. Në këto programe, aktivitetet e propozuara në Planin aksionar në mënyrë plotësuese janë përpunuar në projekte të cilët qartë do të definojnë qëllimet projektuese dhe rezultatet e pritura, indikatorët, shpenzimet e nevojshme dhe subjektet përgjegjëse për realizimin e tyre. Korniza e Planit aksionar është bërë mbi bazën e Strategjisë për të rinjë të Komunës së Strugës 2015 – 2020, e cila edhe zyrtarisht u miratua nga ana e Këshillit të Komunës së Strugës në mbledhjen e mbajtur në shkurt të vitit 2015. Procesi i planifikimit aksionar u realizua në bashkëpunim me palët e interesuara, pjesëmarrëse në sesionet planifikuese (punëtori) dhe nëpër proces të dëgjësave dhe konsultave publike me strukturat kompetente në Komunën e Strugës dhe sektorit civil.

3 Më gjerësisht mbi strukturën, qëllimet, aktivitetet e hapave të detajuara të planit të miratuar aksionar shiko: Plani aksionar për strategjinë lokale për të rinjë të Komunës së Strugës në periudhën 2015 – 2017.

4. METODOLOGJIA E PROCESIT TË MONITORIMIT

Monitorimi i strategjisë lokale dhe planit aksionar për bashkëpunim me të rinjtë u zhvillua nga njëra anë mbi bazën e realizimit të intervistave të drejtpërdrejta dhe pyetësorëve me persona përgjegjës për implementimin e të njejtëve, kurse nga ana tjetër me shfrytëzuesit e fundit të politikave/aktiviteteve të dokumenteve strategjike, me qëllim të përfitimit të rezultateve dhe përgjigjeve më konzistente të pyetjeve konkrete për implementimin e aktiviteteve. Ky monitorim përfshinte dy kategori të intervistuarve:

- **Takime/pyetësorë** – me përfaqësues të organizatave rinore joqeveritare që kanë marrë pjesë në krijimin e programit për zhvillim, me organizata të tjera joformale të rajonit që janë aktivë dhe do donin më tej të përfshihen në procesin e takimeve individuale me përfaqësuesit e institucioneve relevante – përgjegjës për implementimin e një pjese të aktiviteteve të planit aksionar si dhe me institucione që janë shfrytëzues të vetë strategjisë për të rinjë:
 - Pyetësor për Komunën e Strugës i cili përbëhej nga 19 pyetje:
 - Pyetësi ishte dedikuar për këto sektorë: arsim, kulturë, mbrojtje sociale, sport dhe rini, dhe
- Pyetësor për koordinatorin për monitorimin e implementimit.
- Pyetësor për institucionet arsimore i cili përbëhej nga 16 pyetjeve:
 - Me këtë pyetësor ishin përfshirë shkollat e mesme dhe
 - Pyetësor për institucionet për arsim të lartë/univerzitetet.
- Pyetësor për organizatat joqeveritare i cili përbëhej nga 17 pyetje:
 - Nga gjithsej 135 organizata të regjistruara joqeveritare që veprojnë në Komunën e Strugës, vetëm 35 organizata janë aktive. Organizata që kanë veprimtari rininë ose përfshijnë në statutin e tyre aktivitete për të rinjë, përfshirë edhe shoqëritë kulturoro-artistike janë 32.
- **Fokus grupet** – me të rinjë nga mosha 15-18 vjet të cilët ndjekin arsim në shkollat e mesme në Strugë:
- Pyetësor për fokus grupet i cili përbëhej nga 12 pyetje:
 - Pyetësor për 2 fokus grupe.

Në kuadër të zbatimit të procesit të monitorimit, pjesa më e madhe e të intervistuarve nuk u përgjigjën në pyetësonin që ju dorëzua me email, dhe për këtë arsye rezervuam edhe takime të drejtëpërdrejta për kryerjen e intervistës në formën e pyetjeve të planifikuara. Nga gjithsej 41 shfrytëzues dhe organe të monitoruara përgjegjës për implementimin e strategjisë dhe planit aksionar për të rinjë, përgjigje për takim ose plotësim të pyetësonit me email kemi pranuar nga 28 organizata/institucione, respektivisht 68% të organizatave/institucioneve që u planifikuan.

Pyetësoni mbi bazën e të cilit monitorohej strategjia lokale dhe plani aksionar për të rinjë përbëhej nga pyetje me përgjigje të dhëna të mundshme dhe pyetje të llojit të hapur.

Cjithashtu janë mbajtur 2 takime me Qendrën e bashkësisë së Komunës së Strugës me qëllim që të fitohen informacione më të detajuara në raport me aktivitetet e realizuara nga ana e tyre dhe aktivitete të zbatuara nga subjekte të tjera të përfshira në planin aksionar.

5. ANALIZA E TË DHËNAVE DHE KONKLUZAT KRYESORE

Implementimi mbi bazën e prioriteteve dhe qëllimeve strategjike

A është miratuar program për zhvillimin e iniciativave rinore, program për angazhimin e njerëzve të rinjë të edukuar, program për zhvillimin e projekteve në fushën e ndërmarrësisë dhe punësimit të rinjve, program për përfshirjen e të rinjve në zhvillimin e jetës socio-kulturore në komunë, program për përfshirjen e të rinjve në mbrojtjen e mjedisit jetësor, program për forcimin e kapaciteteve të komunës

për bashkëpunim me të rinjtë, program për mbështetjen e forcimit të kapaciteteve të organizatave rinore dhe program për shfrytëzimin më të mirë të mjeteve të UE-së dhe fondëve tjera ishin pyetjet kryesore ju parashtruan komunës në të katër fushat (pyetjet QK1 1.1, QK3 3.1, SSH2 2.2, 2.3, 2.4, ZHK1 1.1, ZHK2 2.1 dhe MB2 2.2).

Masa/iniciativa të parashikuara në hartën e balancuar të treguesve të Komunës së Strugës




Nga nëpunësit e intervistuar nga katër sektorë të Komunës, në pyetjen se a është miratuar program për zhvillimin e iniciativave rinore, 1 njësi (arsim dhe kulturë) u përgjigjën se pjesërisht është miratuar (33,3%), 1 njësi (sport dhe shoqata civile) është miratuar (33,3%), dhe 1 njësi (Mbrojtje sociale, mbrojtje të fëmijëve dhe mbrojtje shëndetësore) se nuk është miratuar (33,3%), kurse të gjitha programet tjera nuk janë miratuar në tërësi.

Nëpunësit nga tre njësi u përgjigjën se të gjithë projektet/aktivitetet që kanë të bëjnë me rininë në Komunën e Strugës janë pjesë e aktiviteteve në programet ekzistuese të Komunës në fushat Sport dhe Shoqata civile, Arsim dhe Kulturë, Mbrojtje Sociale, Mbrojtje të fëmijëve dhe Mbrojtje shëndetësore.

Në këtë pyetësor kishte edhe pyetje të hapura të cilave personat e intervistuar duhej të japin përgjigje personale. Pyetjet kishin të bënin me atë se çgarë masash janë ndërmarrë për secilin prioritet strategjik për të katër perspektivat. Nga 3 njësitë e komunës vetëm nga 2 njësi (Arsim dhe kulturë; Sport dhe shoqata civile) personat përgjegjës në insitucion nga gjithsej 9 pyetje, janë përgjigjur vetëm në 6 pyetje (pyetjet QK1 1.2, QK2 2.1, QK3 3.2, SSH1 1.2, SSH2 2.1, SSH3 3.1 dhe MB1 1.1): komunikim dhe bashkëpunim; formimi i këshillit rinor; mbështetja financiare për OJQ-të për të rinjtë – manifestime kulturore, klube sportive; mbështetje të arsimit të mesëm profesional – mbështetje për shkollën e mesme të muzikës (edhe pse është institucion shtetëror), forum mbi buxhetin e komunës (2015,2016), mbështetje financiare për shkollat fillore në implementimin e projekteve multikulturore, forum qytetar, përfshirja e të rinjve në vendimmarrje se cilat projekte do të realizohen nga komuna, debate publike.

Masa të ndërmarra për secilin prioritet strategjik për katër perspektivat nga ana e komunës



Në pyetjen (MB2 2.1) a është formuar fond për mbështetjen e UE-së dhe projekteve të tjera të huaja, të gjithë 4 sektorët u përgjigjën se nuk është formuar, kurse në pyetjen (SSH1 1.1) a është vendosur strukturë formale për mbështetjen e të rinjve, vetëm 1 sektor (kulturë) u përgjigj se është formuar strukturë e tillë (Qendra e bashkësisë së Komunës së Strugës).

Në administratën komunale nuk është emëruar person/koordinator i cili do ta monitorojë implementimin e strategjisë dhe planit aksionar. Të dhënat janë grumbulluar individualisht me çdo udhëheqës të sektorit ose person përgjegjës për koordinim në sektor.

Informim, përfshirje dhe implementim të organeve/trupave tjerë në raport me strategjinë lokale për të rinjë dhe planin aksionar

Institucionet arsimore

Pyetësori i rradhës ishte dedikuar për institucionet arsimore në Komunën e Strugës, nga gjithsej 5 institucione arsimore (shkolla të mesme dhe institucione të arsimit të lartë/univerzitetet), nga të cilët vetëm 2 dhanë përgjigje për pyetësorin (1 shkollë e mesme dhe 1 univerzitet).

Sa i përket faktit se a janë të informuar se ka plan aksionar për strategjinë lokale për të rinjë dhe se a kanë marrë pjesë në përgatitjen e planit aksionar (pyetja 6), 1 institucion u përgjigj negativisht kurse tjetra pozitivisht, ndërsa për pyetjet (7, 8, 9, 10) a jeni të informuar për programin për zhvillimin e iniciativave rinore, a jeni të informuar për masat për forcimin e partneriteteve me organizatat rinore, a jeni të informuar për masat për përfshirjen e të rinjve në projektet multikulturore dhe vallë të rinjtë/organizatat rinore janë të përfshira në procesin e planifikimit të buxhetit për rininë (financimi i iniciativave dhe aktiviteteteve rinore) të dy institucionet janë përgjigjur negativisht.

Sa i përket implementimit të projekteve/iniciativave/aktiviteteve për të rinjë nga ana e institucioneve të tyre (pyetja 1), 2 institucione dhanë shembull për përfshirjen aktive të rinisë.

Në pyetjen se a po ndërmerren masa për reduktimin e migrimit të njerëzve të rinjë të arsimuar – 2 institucione u përgjigjën pozitivisht. Ja disa shembuj: aktivitete që i sensibilizojnë të rinjtë për mundësinë e punësimit, ide të reja për projekte që përfshijnë të rinjtë, përfshirjen e të rinjve në implementimin e projekteve të ndryshme.

Shembuj të masave të ndërmarra për reduktimin e migrimit të njerëzve të rinjë të arsimuar

aktivitete që i sensibilizojnë të rinjtë për mundësinë e punësimit

ide të reja për projekte që përfshijnë të rinjtë


përfshirjen e të rinjve në implementimin e projekteve të ndryshme

Organizatrat joqeveritare

Nga gjithsej 32 shfrytëzues të monitoruar të strategjisë për të rinjë – organizata joqeveritare që kanë për veprimtari rinjë ose përfshijnë në statutin e tyre aktivitete për të rinjë, përfshirë edhe shoqëritë kulturoro-artistike në Komunën e Strugës, vetëm 59% të të intervistuarve ju përgjigjën pyetësorit, ndërsa 41% prej tyre nuk ju përgjigjën thirrjes tonë.

Në pyetjen a kanë dijeni se ekziston Plan aksionar për strategjinë për të rinjë, 37% u përgjigjën se nuk kanë informacion të tillë, ndërsa 63% u përgjigjën se kanë dijeni për Planin aksionar, nga të cilët 50% kishin qenë të përfshirë në përgatitjen e strategjisë për të rinjë, kurse 50% nga to nuk kishin qenë të përfshirë në përgatitjen e strategjisë.


A e dini se ka Plan aksionar për strategjinë për të rinjë?



Sa anëtarë / aktivistë të rinjë ka organizata juaj, 16% u përgjigjën se kanë më pak se 5, 26% u përgjigjën se kanë nga 5 deri 10, ndërsa 58% u përgjigjën se kanë mbi 10 anëtarë.

Sa i përket pyetjes – A kanë informacion për programet dhe masat për të rinjë nga strategjia për të rinjë (pyetjet 8, 9 dhe 10): 16% kanë dijeni për to, 16% pjesërisht i njohin këto programe dhe masa, kurse 68% nuk kanë asnjë informacion për to.


A keni informacion për programet dhe masat për të rinjë nga strategjia për të rinjë?



Të rinjtë/organizatat rinore a janë të përfshirë në procesin e planifikimit të buxhetit për të rinjë (financimi i iniciativave dhe aktiviteteve rinore): 21% të intervistuarve u përgjigjën me po, 58% nga to u përgjigjën me jo, dhe 11% u përgjigjën se nuk e dijnë.

Madje 84% të organizatave u përgjigjën se kanë imlpemenuar projekte/iniciativa/aktivitete për të rinjë, edhe atë festivale muzikore, festivale filmi, fushata për rritjen e vetëdijes te të rinjtë për sfera të ndryshme, trajnime, diskutime, punëtori, orë të mbitrajnimit, kampe, aksione zbuluese, koncert baleti, seksione vallesh dhe këndimi, dita e modës; ndërsa 16% nga to në aktivitetet e tyre target grupi ishte i përzier, përfshirë edhe të rinjtë.

A keni implementuar projekte/iniciativa/aktivitete për të rinj?




Fokus grupet

Qëllimi i këtyre pyetjeve ishte të njohtohemi se vallë dhe sa nga personat e intervistuar në institucionet arsimore kanë dijeni dhe sa prej personave të intervistuar kanë njohuri për dokumentet për të cilat bëhet monitorimi – raporti, si dhe për programe dhe masa të dala nga këto dy dokumente.

Në këtë pjesë do ti prezantojmë përgjigjet dhe rezultatet e përgjigjeve nga dy fokus grupe të mbajtura me të rinjë të moshës nga 14-18 vjeç të shkollave të mesme të mesme të Komunës së Strugës. Pyetëtori përmban gjithsej 12 pyetje, nga të cilat 5 janë pyetje të hapura përmes së cilave dëshironim të marrim informacion se sa sipas mendimit të tyre implementohen aktivitetet dhe projektet për të rinjë në komunën ku jetojnë. Me këtë pyetësor ishin përfshirë gjithsej 30 nxënës të shkollave të mesme, nga të cilët 53% ishin femra dhe 47% meshkuj.

Në pyetjen a kanë dijeni se në komunë nuk ka njësi të posaçme për të rinjë, vetëm 10% u përgjigjën me po, ndërsa 90% prej tyre u përgjigjën me jo.

Përfshirja sipas gjinisë



A e dini se në komunë ka njësi të posaçme për të rinjë?



Në pyetjen se a kanë dëgjuar për dokumentin e Komunës – Strategjinë për të rinj, a e dini se Komuna e Strugës duhet të miratojë / të sjell disa programe për të rinjë dhe a keni dijeni për aktivitetet për të rinjë që Koamuna e Strugës i ka realizuar ose planifikon ti realizojë në të ardhmen, të gjithë të intervistuarit u përgjigjën me jo.

Në pyetjen sa janë aktivë në disa prej organizatave joqeveritare ose iniciativa të tjera, 40% u përgjigjën se janë aktivë dhe të përfshirë në aktivitete të ndryshme, ndërsa 60% u përgjigjën se nuk janë aktivë.


Sa i përket faktit se sa të rinjtë dëshirojnë të largohen nga vendi, në pyetjen ku e paramendoni ardhmërinë tuaj, vetëm 40% u përgjigjën se dëshirojnë të mbeten në vend, ndërsa 60% u përgjigjën se dëshirojnë të largohen nga vendi.

Implementimi i Planit aksionar në periudhën 2015-2017

Nga gjithsej 51 aktivitete të Planit aksionar të parashikuara të implementohen në periudhë prej tre vitesh 2015-2017 - 25% të aktiviteteve janë të planifikuara në vitin 2015, 33% në vitin 2016, ndërsa në vitin 2017 ka aktivitete që implementohen në vazhdimësi gjatë tre viteve të Planit aksionar, respektivisht 39% të aktiviteteve të përgjithshme për realizim.

Implementimi i aktiviteteve nga gjithsej 51 aktivitete, 39% janë aktivitete të implementuara, ndërsa 61% janë aktivitete të përealizuara të parashikuara sipas kornizës kohore të planit.

Në vitin 2015, nga gjithsej 13 aktivitete të planifikuara për implementim, vetëm 69% janë aktivitete të realizuara dhe 31% mbeten të përealizuara në kornizën e parashikuar kohore.

Implementimi i aktiviteteve të parashikuara sipas kornizës kohore të Planit aksionar

Në vitin 2016, nga gjithsej 17 aktivitete të planifikuara për implementim, 72% të aktiviteteve nuk janë realizuar dhe vetëm 28% nga to janë realizuar.

Aktivitetet që ishin planifikuar të zbatohen gjatë tre viteve 2015-2017 përfundimisht me vitin 2016 - 55% të aktiviteteve janë të realizuara, kusre 45% nuk janë implementuar.

6. KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET

Konkluzionet

- Plani aksionar propozon masa dhe iniciativa që duhet ti sigurojnë qëllimet prioritare, treguesit kryesor për arritjen e tyre, vlerat qëllimore që dëshiron ti arrijë Komuna në fushën e të rinjve, si dhe të arrijë vizionin e saj për zhvillimin dhe rolin e të rinjve në Komunë. Komuna me palët e saj të interesuara me përfshirje të konsiderueshme (organizatat rinore dhe Administrata komunale) përmes mënyrës konsultative dhe dhe participative në krijimin e Strategjisë dhe Planit aksionar, kanë siguruar fleksibilitet dhe tolerancë ndaj sjelljes së strukturave lokale gjatë realizimit të aktiviteteve të Planit aksionar si dhe kanë dhënë kornizë të arsyeshme kohore për realizimin e aktiviteteve.
- Duke pasur parasysh faktin se në Komunën e Strugës nuk ekziston Njësi e posaçme as edhe sektor për bashkëpunim me të rinjtë, zbatimi i Planit aksionar në nivel vjetor realizohet nëpërmjet programeve të përpiluara për fusha të ndryshme të kompetencave të Komunës së Strugës ose me përpilimin e programit të posaçëm ndërsektorial për bashkëpunim me të rinjtë. Shkalla e realizimit të aktiviteteve sipas kornizës kohore është e kënaqshme dhe po zhvillohet shumë mirë edhe atë për vitin 2015 shkalla e realizimit ishte 69%, ndërsa nga të gjitha aktivitetet e realizuara për periudhën 2015-2017 shkalla e realizimit është 39%.
- Të rinjtë që jetojnë në Komunën e Strugës nuk janë shumë të informuar për dy dokumentet strategjike që janë dedikuar për të rinjtë si shfrytëzues të fundit dhe ekziston tendenca te to që të largohen sa më shumë nga shteti.
- Të rinjtë në numër të konsiderueshëm nuk janë të interesuar të përfshihen dhe të jenë aktiv në bashkësinë etyre dhe nuk janë të informuar për masat dhe iniciativat e planifikuara si dhe për shkallën e realizimit të tyre.
- Institucionet arsimore kanë qasje specifike për përfshirjen e të rinjve në aktivitete, iniciativa, projekte të ndryshme të cilat zakonisht janë si iniciativa të brendshme të vetë institucionit ose të organizuara nga subjekt ti tretë financiar nga donatorë të ndryshëm. Ata mbeten të hapur për çdo ini-

ciativë që do të kontribuojë për të mirën e të rinjve dhe sigurisht në përmbushjen e indikatorëve nga dy dokumentet.

- Duke pasur parasysh faktin se Plani aksionar për të rinjë për periudhën 2015-2017 ka edhe dy vjet deri në implementimin përfundimtar, Komuna e Strugës, Njësitë në Komunë, shkollat, sektori joqeveritar, mebeten të përkushtuar në realizimin e aktiviteteve të mbetura.
- Masat dhe aktivitetet e Planit aksionar për të rinjë që ishin parashikuar për tu zbatuar gjatë vitit 2015 ishin financuar në kuadër të mjeteve të aprovuara buxhetore ose projekteve të financuara nga donatorë të tjerë të vendit dhe të huaj.
- Masat në prioritetet individuale nuk janë realizuar tërësisht por prapë mund të konstatohet se ka progres të konsiderueshëm në arritjen e qëllimeve të përcaktuara në Planin aksionar.

Rekomandimet:

- Mbështetje në krijimin dhe forcimin e kulturës për përfshirje dhe pjesëmarrje aktive të rinjve në aktivitete dhe iniciativa të ndryshme;
- Nxitja e partneritetit dhe bashkëpunimi ndërsektorial ndërmjet organeve shtetërore, shoqërisë civile, qendrave arsimore dhe hulumtuese dhe komunitetit afarist;
- Trajnime falas për të rinjtë, udhëtime studimore, këmbim të përvojave;
- Rritja e aktiviteteve në promovimin e programeve të disponueshme për mbështetjen e të rinjve me qëllim të rritjes së vetësisjes së tyre, informimit dhe përfshirjes;
- Krijimi i Infoqendrës për të rinjë;
- promovim më të madh për sigurimin e dukshmërisë së shoqatave rinore dhe organizatave për mbështetjen e të rinjve;
- Ndjekja e trendeve dhe hulumtimeve të rregullta për nevojat e të rinjve dhe zgjerimi i shërbimeve në përputhje me konkluzat;
- Rritja e mjeteve buxhetore komunale dedikuar për iniciativat dhe aktivitetet rinore;

7. BURIMET

Dokumente, strategji, publikime, hulumtime

- Komuna e Strugës, Strategjia për të rinjë 2015-2020, Strugë 2015
- Harta sociale e Komunës së Strugës, 2016 në dispozicion në: <http://www.soros.org.mk/mk/Home/Publication?newsID=6152&catID=10&pageIndex=1> , si dhe <http://www.struga.gov.mk/index.php/mk/>
- Komuna e Strugës, Plani aksionar për strategjinë lokale për të rinjë të Komunës së Strugës për periudhën 2015 – 2017
- Plani aksionar për punësimin e të rinjve 2015 (Ministria e punës dhe politikës sociale)
- Hulumtim mbi nevojat dhe sfidat e të rinjve ndërmarrës në R. e Maqedonisë (Fondacioni YES)

Të dhëna nga intervista/pyetësorë

- Të dhëna nga pyetësori i Njësisë për arsim, rini dhe kulturë të Komunës së Strugës
- Të dhëna nga pyetësori i Njësisë për sport dhe shoqata civile të Komunës së Strugës
- Të dhëna nga pyetësori i Njësisë për mbrojtje sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore të Komunës së Strugës
- Të dhëna nga pyetësori i dy fokus grupeve me të rinjë të moshës 14-18 vjet
- Të dhëna nga pyetësori i Fondacionit EUGEN 2011
- Të dhëna nga pyetësori i Shoqatës kulturore artistike Rrënjët e Strugës - Strugë
- Të dhëna nga pyetësori i organizatës joqeveritare Ëndrra Rinore

- Të dhëna nga pyetësi i Shoqatës për zhvillim dhe aktivizëm AKVA Strugë
- Të dhëna nga pyetësi i Shoqatës Agjencia lokale për zhvillim Strugë
- Të dhëna nga pyetësi i Vepro Strugë
- Të dhëna nga pyetësi i Shoqatës ORGANIZATA RINORE ALTERNATIVA Strugë
- Të dhëna nga pyetësi i Studio për kërcim BAH
- Të dhëna nga pyetësi i Këngë Jeho
- Të dhëna nga pyetësi i Shoqatës Iniciativa për aktivizëm të pavarur kulturor INKA
- Të dhëna nga pyetësi i Këshillit rinor Strugë
- Të dhëna nga pyetësi i SHKA Ilinden Strugë
- Të dhëna nga pyetësi i Kreativë dhe Aktivë Strugë
- Të dhëna nga pyetësi i SHOQATËS MALORE EKOLOGJIKE ZAKAMEN
- Të dhëna nga pyetësi i Forumit rinor arsimor Strugë
- Të dhëna nga pyetësi i Institutit për hulumtim social dhe zhvillim të qëndrueshëm
- Të dhëna nga pyetësi i Studios së dramës Milladin
- Të dhëna nga pyetësi i SHMK Gjimnazi Dr Ibrahim Temo
- Të dhëna nga pyetësi i Univerziteti Evropian Strugë
- Të dhëna nga pyetësi i Shoqatës MULTIVIZION
- Të dhëna nga pyetësi i Ardhmërisë me të rinjtë

Veb faqe

- <http://www.struga.gov.mk>.
- <http://www.ccstruga.mk>.
- <http://www.nms.org.mk/mk/2016/05/> (Нациоален младински совет на Македонија)
- <http://kanal77.mk/билет-во-два-правца-мостот-на-поезиј/>
- <http://www.alsat-m.tv/mk/293115/>
- <http://www.yes-network.org/izveshtai-i-dokumenti/>
- <http://www.mtsp.gov.mk/dokumenti.nspх>
- http://www.sega.org.mk/web/index.php?option=com_content&view=category&layout=blog&id=139&Itemid=256&lang=mk

8. ANEKS

Shtojca 1: Pyetësor për monitorimin e Strategjisë lokale dhe Planit aksionar për të rinjë të Komunës së Strugës (pyetësor për sektorin Kulturë, Arsim, Sport dhe Rini, Mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve në Komunën e Strugës)

QYTETARË TË KËNAQUR

QK1: Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset e sjelljes së vendimeve në Komunë;

1.1 PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN E INICIATIVAVE RINORE

(a është miratuar programi për zhvillimin e iniciativave rinore)

PO

JO

1.2 MASA PËR FORCIMIN E PARTNERITETEVE ME ORGANIZATAT RINORE

(çfarë masash janë marrë për forcimin e partneriteteve me organizatat rinore)

-

-

-

-

QK2: Rritja e përfshirjes së të rinjve në realizimin e projekteve multikulturore;

2.1 MASA PËR PËRFSHIRJEN E TË RINJVE NË PROJEKTE MULTIKULTURORE NGA QYTETI I STRUGËS DHE NGA MJEDISËT RURALE

(çfarë masash janë marrë për përfshirjen e të rinjve në projekte multikulturore)

-
-
-
-

QK3: Ulja e migrimit të njerëzve të rinjë të edukuar.

3.1 PROGRAM PËR ANGAZHIMIN E NJERËZVE TË RINJË TË EDUKUAR

(a është miratuar program për angazhimin e njerëzve të rinjë të edukuar)

PO

JO

3.2 MASA PËR ARSIM PËR NEVOJAT E TREGUT TË PUNËS

(çfarë masash janë marrë për arsim për nevojat e tregut të punës)

-
-
-
-

3.3 MASA PËR PËRFSHIRJEN E TË RINJVE NË TREGUN E PUNËS

(çfarë masash janë marrë për përfshirjen e të rinjve në tregun e punës)

-
-
-
-

SIGURIMI I SHËRBIMEVE

(çfarë lloji i mënyrës është përdorur)

SSH1: Rritja e efektivitetit në sigurimin
e shërbimeve për të rinjtë;1.1 VENDOSJA E STRUKTURËS FORMALE PËR
MBËSHTETJEN E TË RINJVESSH2: Rritja e numrit të projekteve drejtuar
për të rinjtë;

(a është vendosur strukturë për mbështetjen e të rinjve)

PO

JO

(çfarë aktivitete realizon)

2.1 MASA PËR PËRFSHIRJEN E TË RINJVE NË ZHVILLIMIN
DHE IMPLEMENTIMIN E PROJEKTEVE(çfarë masash janë marrë për përfshirjen e të rinjve në
zhvillimin dhe implementimin e projekteve)1.2 PËRFSHIRJA E TË RINJVE NË KRIJIMIN E SHËRBIMEVE
PËR NEVOJAT E TË RINJVE NË NIVEL LOKAL(a janë të përfshirë të rinjtë në krijimin e shërbimeve për
nevojat e të rinjve në nivel lokal)

PO

JO

2.2 PROGRAM PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTEVE NË FUSHËN
E NDËRMARRËSISË DHE PUNËSIMIT TË RINJVE

(a është miratuar program për zhvillimin e projekteve në fushën e ndërmarrësisë dhe punësimit të rinjve)

PO

JO

2.3 PROGRAM PËR PËRFSHIRJEN E TË RINJVE NË
ZHVILLIMIN E JETËS SOCIO-KULTURORE NË KOMUNË

(a është miratuar program për përfshirjen e të rinjve në zhvillimin e jetës socio-kulturore)

PO

JO

2.4 PROGRAM PËR PËRFSHIRJEN E TË RINJVE NË
MBROJTJEN E MJEDISIT JETËSOR

(a është miratuar program për përfshirjen e të rinjve në mbrojtjen e mjedisit jetësor)

PO

JO

SSH3: Avancimi dhe zhvillimi i arsimit formal
dhe joformal të rinjve.

3.1 MASA PËR AVANCIMIN DHE ZHVILLIMIN E ARSIMIT
FORMAL TË RINJVE

(çfarë masash janë marrë për avancimin dhe zhvillimin e arsimit formal të rinjve)

-

-

-

-

3.2 MASA PËR AVANCIMIN DHE ZHVILLIMIN E ARSIMIT
JOFORMAL PËR TË RINJTË

(çfarë masash janë marrë për avancimin dhe zhvillimin e arsimit joformal të rinjve)

-

-

-

-

ZHVILLIMI I KAPACITETEVE

ZHK1: Përforcimi i kapaciteteve të Komunës për bashkëpunim me të rinjtë;

1.1 PROGRAM PËR FORCIMIN E KAPACITETEVE TË KOMUNËS PËR BASHKËPUNIM ME TË RINJTË

(a është miratuar program për forcimin e kapaciteteve të komunës për bashkëpunim me të rinjtë)

PO

JO

ZHK2: Përforcimi i kapaciteteve të organizatave rinore.

2.1 PROGRAM PËR MBËSHTETJEN E FORCIMIT TË KAPACITETEVE TË ORGANIZATAVE RINORE

(a është miratuar program për mbështetjen e forcimit të kapaciteteve të organizatave rinore)

PO

JO

MENAXHIMI ME BUXHETIN

MB1: rritja e buxhetit për aktivizëm rinor;

1.1 MASA PËR PËRFSHIRJEN E TË RINJVE NË PLANIFIKIMIN E BUXHETIT

(çfarë masash janë marrë për përfshirjen e të rinjve në planifikimin e buxhetit)

-
-
-
-

MB2: Rritja e mjeteve jobuxhetore për mbështetjen e organizatave rinore.

2.1 FORMIMI I FONDIT PËR MBËSHTETJE TË UE-së DHE PROJEKTEVE TË TJERA TË HUAJA

(a është formuar fond për mbështetje nga UE dhe projekte të tjera të huaja)

PO

JO

2.2 PROGRAM PËR SHFRYTËZIM MË TË MIRË TË MJETEVE
TË UE-së DHE FONDEVE TË TJERA

(a është miratuar program për shfrytëzim më të mirë të
mjeteve të UE-së dhe fondeve të tjera të huaja)

PO

JO

Shtojca 2: Pyetësor për monitorimin e Strategjisë lokale dhe Planit aksionar për të rinjë të Komunës së Strugës
(pyetësor për institucionet arsimore)

1. Numëroni sa projekte/iniciativa/aktivitete për të rinjë ka realizuar institucioni juaj për dy vitet e fundit?

-
-
-
-

2. Kush është donatori juaj kryesor/mbështetësi financiar i projekteve tuaja?

Fondacione/organizata ndërkombëtare institucione qeveritare

3. A ka pranuar organizata juaj mbështetje financiare nga Komuna për dy vitet e fundit?

PO

JO

4. A keni bashkëpunim me Komunën e Strugës?

PO

JO

Nëse po, në çfarë niveli mund të karakterizoni këtë bashkëpunim?

Mirë

Shumë mirë

Shkëlqyeshëm

5. Sa janë të rinjtë aktiv në evenimente të ndryshme që implementohen nga institucioni juaj ose i jashtëm?

Pak

Konsiderueshëm

Shumë

6. A e dini se Komuna e Strugës ka Plan aksionar për strategjinë lokale për të rinjë?

PO

JO

Nëse po, a keni marrë pjesë në përgatitjen e Strategjiës për të rinjë?

PO

JO

7. A jeni të informuar për programin për zhvillim të iniciativave rinore?

PO

JO

8. A jeni të informuar për masat për forcimin e partneriteteve me organizatat rinore?

PO

JO

9. A jeni të informuar për masat për përfshirjen e të rinjve në projektet multikulturore?

PO

JO

10. A janë të rinjtë/organizatat rinore të përfshirë në procesin e planifikimit të buxhetit për të rinjë (financimi i iniciativave dhe aktiviteteve rinore)?

PO

JO

11. A keni marrë pjesë në trajnime për fonde nga donatorë të ndryshëm nga vendi dhe jashtë Maqedonisë të organizuara nga komuna ose institucione/organizata të tjera?

PO

JO

12. A keni marrë pjesë në trajnime për forcimin e kapaciteteve të organizatave rinore, të organizuara nga ana e Komunës së Strugës ose organizatave/institucioneve të tjera?

PO

JO

13. A mendoni se po mirren masa për uljen e migrimit të njerëzve të rinjë të edukuar? Nëse Po, cilat?-
-
-
-

14. A jeni të informuar për Qendrën e bashkësisë së Komunës së Strugës?

PO

JO

Nëse po, a e dini se çfarë roli ka kjo qendër në implementimin e Planit aksionar për strategji lokale për të rinjë?

PO

JO

15. Në çfarë aktivitete të organizuara nga Komuna e Strugës/Qendra e bashkësisë institucioni juaj ka marrë pjesë?
-
-
-
-

16. A mund të numëroni disa iniciativa/aktivitete/ programe për të rinjë që realizohen në Komunën e Strugës (në qytet dhe mjediset rurale)
-
-
-
-

Shtojca 3: Pyetësor për monitorimin e Strategjisë lokale dhe Planit aksionar për të rinjë të Komunës së Strugës (pyetësor për OJQ-të)

1. Numëroni sa projekte/iniciativa/aktivitete për të rinjë ka realizuar organizata juaj për dy vitet e fundit?

-
-
-
-

2. Kush është donatori juaj kryesor/mbështetësi financiar i projekteve tuaja?

Fondacione/organizata ndërkombëtare

institucione qeveritare

3. A ka pranuar organizata juaj mbështetje financiare nga Komuna për dy vitet e fundit?

PO

JO

4. A keni bashkëpunim me Komunën e Strugës?

PO

JO

Nëse po, në çfarë niveli mund të karakterizoni këtë bashkëpunim?

Mirë

Shumë mirë

Shkëlqyeshëm

5. Sa nËtarË/tË rinjË aktivË ka organizata juaj?

MË pak se 5 5 deri 10 10 e mË tepËr

6. AnËtarËt aktiv tË organizatËs suaj janË

Vullnetar Honorar

7. A e dini se Komuna e StrugËs ka Plan aksionar pËr strategjinË lokale pËr tË rinjË?

PO JO

NËse po, a keni marrË pjesË nË pËrgatitjen e StrategjiËs pËr tË rinjË?

PO JO

8. A jeni tË informuar pËr programin pËr zhvillim tË iniciativave rinore?

PO JO

9. A jeni tË informuar pËr masat pËr forcimin e partneriteteve me organizatat rinore?

PO JO

10. A jeni tË informuar pËr masat pËr pËrfshirjen e tË rinjve nË projektet multikulturore?

PO JO

11. A janË tË rinjtË/organizatat rinore tË pËrfshirË nË procesin e planifikimit tË buxhetit pËr tË rinjË (financimi i iniciativave dhe aktiviteteve rinore)?

PO JO

12. A keni marrË pjesË nË trajnime pËr fonde nga donatorË tË ndryshËm nga vendi dhe jashtË MaqedonisË tË organizuara nga komuna ose institucione/organizata tË tjera?

PO JO

13. A keni marrë pjesë në trajnime për forcimin e kapaciteteve të organizatave rinore, të organizuara nga ana e Komunës së Strugës ose organizatave/institucioneve të tjera?

PO

JO

14. A mendoni se po mirren masa për uljen e migrimit të njerëzve të rinjë të edukuar?
Nëse Po, cilat?

-

-

-

-

15. A jeni të informuar për Qendrën e bashkësisë së Komunës së Strugës?

PO

JO

Nëse po, a e dini se çfarë roli ka kjo qendër në implementimin e Planit aksionar për strategji lokale për të rinjë?

PO

JO

16. Në çfarë aktivitete të organizuara nga Komuna e Strugës/Qendra e bashkësisë institucioni juaj ka marrë pjesë?

-

-

-

-

17. A mund të numëroni disa iniciativa/aktivitete/ programe për të rinjë që realizohen në Komunën e Strugës (në qytet dhe mjediset rurale)

-

-

-

-

Shtojca 4: Pyetësor për monitorimin e Strategjisë lokale dhe Planit aksionar për të rinjë të Komunës së Strugës
(pyetësor për fokus grupet)

1. A jeni aktivist në ndonjë organizatë
dhe në cilën?

PO

JO

-
-
-
-

2. A punoni si vullnetar ose me honorar?

Vullnetar

Honorar

3. A keni marrë pjesë në trajnime/seminare/
punëtori të organizuara nga OJQ-të për
të rinjë ose institucione të tjera?

PO

JO

-

4. Çfarë roli ka Komuna në bashkësinë tuaj?

-
-
-
-

5. A e dini se Komuna nuk ka Njësi për të rinjë?

PO

JO

6. A keni dëgjuar për dokumentin e
Komunës-Strategjia për të rinjë?

PO

JO

7. A e dini se Komuna e Strugës duhet të
miratojë/të sjell disa programe për të rinjë?

PO

JO

8. Nëse po, për cilat prej tyre keni dëgjuar/lexuar?

1.1 PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN E INICIATIVAVE
RINORE

3.1 PROGRAM PËR ANGAZHIMIN E NJERËZVE
TË RINJË TË EDUKUAR

2.2 PROGRAM PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTEVE
NË FUSHËN E NDËRMARRËSISË DHE
PUNËSIMIT TË RINJVE

2.3 PROGRAM PËR PËRFSHIRJEN E TË RINJVE
NË ZHVILLIMIN E JETËS SOCIO-KULTURORE
NË KOMUNË

2.4 PROGRAM PËR PËRFSHIRJEN E TË RINJVE
NË MBROJTJEN E MJEDISIT JETËSOR

9. A jeni në dijeni për aktivitete për të rinjë që
Komuna e Strugës i ka realizuar ose planifikon
ti realizojë në të ardhmen?

PO

JO

10. Numëroni disa aktivitete/projekte për të rinjë
që i implementon Komuna juaj?

-

-

-

-

11. Ku e shihni ardhmërinë tuaj?

Në komunën ku jetoni
Jashtë Maqedonisë

12. Për çka keni nevojë ju si i ri?

-

-

-

-

